



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 134, Datë 07.06.2021

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS NR. 343, SERIA F16, PËR FURNIZIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE SË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, gërma “ç” dhe nenit 110, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5, pika 1, gërma “d”, 13 dhe 16, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 07.06.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 70/2 prot., datë 10.05.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe relacionin plotësues nr. 70/2-1 prot., datë 04.06.2021, “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, për furnizimin e energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 540 prot., 09.04.2021, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 105, datë 22.04.2021, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 343, Seria F16, së shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën nr. 6/12 prot., data 22.04.2021, është bërë publikimi në median e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës së modifikimit të licencës nr. 343, Seria F16, dhe në përfundim të afatit të njoftimit (datë 07.05.2021), nuk rezultoi të ketë patur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.
- Shoqëria me shkresën nr. 540/1 prot., datë 27.04.2021, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar për të cilin që në aplikimin e saj kishte deklaruar se do ta dorëzonte në ERE sapo ta dispononte.

- Në mbledhjen e bordit të datës 17.05.2021 bordi i ERE-s vendosi të shtyjë vendimmarrjen për rinovimin e licencës nr. 343, Seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për arsye se nevojitej kryerja e disa plotësimeve në lidhje me: Deklaratën për veprimtaritë që kryen shoqëria; Strukturën e organizimit të shoqërisë; Mbajtjen e llogarive të ndara për veprimtaritë e licencuara; Kontratën e qirasë për disponimin e zyrave.
- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën nr. 540/4 prot., datë 02.06.2021, ka paraqitur në ERE sa kërkuar më sipër.
- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., në fazën përfundimtare të procedurës, në bazë të nenit 16, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar*, rezulton tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të rinovojë licencën nr. 343, Seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 10.06.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI